



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.06, datë 29.05.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT PËR OBJEKTET:
“NDËRTIMI I SEGMENTIT TË PARË TË LINJËS 110 kV BALLSH-MARINËZ DHE I
LINJËS BALLSH – DRENOVE NË GJURMË TË RE DHE DEMONTIMI I
SEGMENTEVE TE VJETRA”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejeve të Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh - Marinëz dhe i linjës Ballsh - Drenovë në gjurmë të re dhe demontimi i segmenteve të vjetra”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Mallakastër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINIËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 24/06/2024